





**PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë**

1. Cila nga pjesët A - E duhet të vendoset në mes të dy pjesëve të dhëna ashtu që tëvlejë barazia?



2. Ardiani shikoi në dritare. Ai sheh gjysmën e kengurave që gjenden në park (shih figurën).



Sa kengura gjenden në park?

- (A) 12      (B) 14      (C) 16      (D) 18      (E) 20

*Gara Math Kangaroo - Kosovë*  
*Klasa 3-4*




3. Dy fletë transparente janë errësuar në disa katrorë, siç tregohet në figurë. Ato janë vënë në krye të tabelës që gjendet në mes. Figurat prapa katrorëve të errët nuk mund të shihen. Vetëm njëra nga figurat mund të shihet sërish. Cila është ajo?




- (A) (B) (C) (D) (E)

4. Një figurë e gjurmëve (figura majtas) të këmbëve është kthyer me kokë poshtë (figura djathas). Cilat gjurmë po mungojnë?



- (A) (B) (C) (D) (E)

5. Cili numër fshihet prapa pandës?



- (A) 16 (B) 18 (C) 20 (D) 24 (E) 28

*Gara Math Kangaroo - Kosovë*  
*Klasa 3-4*



6. Mbledhja në tabelështë kryer saktë. Cili numër është në kutinë që ka shenjën e pikëpyetjes?

+	11	7	2
6	17	13	8
	?	11	


- (A) 10                      (B) 12                      (C) 13                      (D) 15                      (E) 16

7. Shkelzeni pa qëllim theu pasqyrën në disa pjesë. Sa pjesë kanë saktësisht katër brinjë?








- (A) 2                      (B) 3                      (C) 4                      (D) 5                      (E) 6

8. Në figurë shohim një gjerdan me gjashtë rruaza.





Cili gjerdan është i njëjtë me gjerdanin e mësipërm?

- (A)       (B)       (C)       (D)       (E) 



**PJESA B: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë**

9. Figura tregon pjesën e përparme të shtëpisë së Hanës. Pjesa e pasme e shtëpisë së saj ka tre dritare dhe nuk ka derë. Çfarë pamje sheh Hana, kur shikon pjesën e pasme të shtëpisë?



10. Jepet

$$\bullet + \bullet + \bullet + \bullet + \blacksquare = \blacksquare + \blacksquare + \blacksquare$$

Cili rast është i saktë?

(A)  $\bullet = \blacksquare$  (B)  $\bullet + \bullet + \bullet = \blacksquare$  (C)  $\blacksquare + \blacksquare + \blacksquare = \bullet$  (D)  $\blacksquare + \blacksquare = \bullet$  (E)  $\bullet + \bullet = \blacksquare$

11. Balonat shiten në pako prej 5, 10 dhe 25 copa. Dardani bleu saktësisht 70 balona. Sa është numri më i vogël i pakove që ai mund të ketë blerë?






- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7



12. Agnesa palosi një copë letër. Ajo bëri vetëm një vrimë në letër. Pastaj ajo shpalosi letrën dhe pa rezultatin, siç tregohet në figurë.



Si e kishte palosur letrën Agnesa?



13. Në pishinë zhvillohet një turne. Së pari u regjistruan 13 fëmijë e pastaj edhe 19 të tjerë. Gjashtë ekipe me numër të barabartë të anëtarëve janë të nevojshme për turneun. Edhe sa fëmijë të paktën duhet të regjistrohen në turne në mënyrë që të mund të formohen gjashtë ekipe?

(A) 1

(B) 2

(C) 3

(D) 4

(E) 5

14. Në fushat e katrorit  $4 \times 4$  janë shënuar disa numra, siç tregohet në figurë. Drini gjeti një katror  $2 \times 2$  në të cilin shuma e numrave në të katër fushat është me madhe.

1	2	1	3
4	1	1	2
1	7	3	2
2	1	3	1

Sa është ajo shumë?

(A) 11

(B) 12

(C) 13

(D) 14


(E) 15



15. Gëzimi dëshiron të gatujë 5 ushqime dhe ka vetëm një shporetë me dy pllaka. Kohët e nevojshme për të gatuar 5 ushqimet janë 40 min, 15 min, 35 min, 10 min dhe 45 min. Sa është koha më e shkurtër në të cilën ai mund ta bëjë këtë? (Ai mund të largojë vetëm një ushqim kur të jetë gatuar.)

- (A) 60 min      (B) 70 min      (C) 75 min      (D) 80 min      (E) 85 min


16. Cili numër duhet të shënohet në rrethin që përmban pikëpyetjen?



- (A) 10      (B) 11      (C) 12      (D) 13      (E) 14

**PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë**


17. Figura tregon një grup të blloqeve të ndërtimit dhe një plan të të njëjtit grup. Në plan ka rënë pak ngjyrë. Cila është shuma e numrave nën fushat e ngjyrosura?



- (A) 3      (B) 4      (C) 5      (D) 6      (E) 7




18. Sa është i gjatë treni?



- (A) 55 m      (B) 115 m      (C) 170 m      (D) 220 m      (E) 230 m

19. Shpresa fillon trajnimin në ora pesë pasdite. Udhëtimi nga shtëpia e saj deri në stacionin e autobusit zgjat 5 minuta. Udhëtimi me autobus zgjat 15 minuta. Asaj i nevojiten 5 minuta për të shkuar nga stacioni i autobusit deri te fusha. Autobusi qarkullon çdo 10 minuta nga ora gjashtë në mëngjes. Në sa ora më së voni ajo duhet të largohet nga shtëpia për të arritur në fushë saktësisht në kohë?



20. Një kopsht i vogël zoologjik ka një gjirafë, një elefant, një luan dhe një breshkë. Suzana planifikoi një turne ku ajo sheh 2 kafshë të ndryshme. Ajo nuk dëshiron të fillojë me luanin. Sa turne të ndryshme mund të planifikojë ajo?

- (A) 3      (B) 7      (C) 8      (D) 9      (E) 12



21. Katër vëllezër kanë ngrënë 11 biskota së bashku. Secili prej tyre ka ngrënë të paktën një biskotë dhe asnjë dyshe prej tyre nuk ka ngrënë të njëjtin numër të biskotave. Tre prej tyre kanë ngrënë 9 biskota së bashku dhe një prej tyre ka ngrënë saktësisht 3 biskota. Sa biskota janë ngrënë nga vëllau i cili ka ngrënë numrin më të madh të biskotave?

- (A) 3                      (B) 4                      (C) 5                      (D) 6                      (E) 7

22. Lulja ka fshehur buzëqeshje 😊 në disa nga fushat e tabelës. Në disa nga fushat tjera ajo shkruan numrin e buzëqeshjeve në fushat fqinje siç tregohet në figurë. Dy fusha themi se janë fqinje në qoftë se ato kanë një anë të përbashkët apo një skaj të përbashkët. Sa buzëqeshje ka fshehur ajo?

	3	3	
2			
		2	
	1		

- (A) 4                      (B) 5                      (C) 7                      (D) 8                      (E) 11




*Gara Math Kangaroo - Kosovë*  
*Klasa 3-4*



23. Secila nga dhjetë çantatpërmban numër të ndryshëm të bomboneve nga 1 deri në 10. Secili nga pesë djemtë, mori dy qese me bombone. Andi mori 5 bombone, Burimi mori 7 bombone, Çuni mori 9 dhe Denisi mori 15. Sa bombone mori Ermiri?

- (A) 9                      (B) 11                      (C) 13                      (D) 17                      (E) 19

24. Lindita ka 4 lule, një me 6 petale, një me 7 petale, një me 8 petale dhe një me 11 petale. Lindita e heq nga një petale prej tri luleve. Ajo e bën këtë disa herë, duke zgjedhur çdo tri lule në secilin rast. Ajo ndalet kur më nuk mund të heq nga një petale nga tre lule. Cili është numri më i vogël i petaleve të cilat mund të mbeten?



- (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 4                      (E) 5

*Gara Math Kangaroo - Kosovë*  
*Klasa 3-4*

